



Konventa
e Këshillit
të Evropës
për Masat
kundër
**Trafikimit
të Qenieve
Njerëzore**



**Të drejtat
e viktimave**

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE



Trafikimi i qenieve njerëzore shkel të drejtat e njeriut dhe ndikon negativisht në jetët e personave të panumurt në Evropë dhe më gjerë. Gjithnjë e më tepër gra, burra dhe fëmijë po tregtohen si mallra, përtej kufijve, ose brenda shteteve të tyre, dhe bien në kurthin e shfrytëzimit dhe të abuzimit.

■ Konventa e Këshillit të Evropës për Masa kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, e cila ka hyrë në fuqi më 1 shkurt 2008, ka për qëllim të:

- ▶ parandalojë trafikimin e qenieve njerëzore,
- ▶ mbrojtë viktimat e trafikimit,
- ▶ ndjekë penalisht trafikantët, dhe të
- ▶ nxisë bashkërendimin e masave në nivel kombëtar si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

■ Konventa zbatohet për:

- ▶ të gjitha format e trafikimit, qofshin ato kombëtare ose përtej kufijve, të lidhura ose jo me krimin e organizuar,
- ▶ të gjithë viktimat e trafikimit (gra, burra dhe fëmijë),
- ▶ të gjitha format e shfrytëzimit (seksual, punë ose shërbime të detyruara, skllavëri, heqje të organeve).

■ Vlera më thelbësore e Konventës është përqendrimi i saj në të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e viktimave. Konventa e përkufizon trafikimin si shkelje të të drejtave të njeriut dhe si shkelje të dinjitetit dhe integritetit të qenieve njerëzore. Kjo do të thotë që organet kombëtare janë përgjegjëse në rast se ato nuk marrin masa për të parandaluar trafikimin e qenieve njerëzore, për të mbrojtur viktimat dhe për të hetuar me efektivitete rastet e trafikimit.

■ Trafikimi i qenieve njerëzore është fenomen mbarëbotëror, i cili nuk njihet kufij. Për këtë arsye Konventa u drejtohet të gjitha shteteve në botë dhe është e hapur për të gjitha këto shtete.

ÇFARË ËSHTË TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE?

— Konventa e përkufizon trafikimin e qenieve njerëzore si kombinim të tre elementëve:

- ▶ si **veprim**: rekrutim, transportim, transferim, strehim ose marrje të personave;
- ▶ si përdorimi të **mjeteve** të caktuara: kërcënimin ose përdorimin e forcës, ose forma të tjera detyrimi, rrëmbim, mashtrim, gënjim, abuzim kompetencash ose të një pozicioni vulnerabiliteti, dhënie ose marrje të pagesave ose të përfitimeve për të marrë pëlqimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër;
- ▶ për **qëllimin e shfrytëzimit**: minimalisht, shfrytëzimin e prostitutimit të të tjerëve, ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punë ose shërbime të detyruara, skllavëri ose praktika të ngjashme me skllavërinë, ose heqjen e organeve.

CILI ËSHTË DALLIMI NDËRMJET TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE DHE KONTRABANDIMIT TË NJERËZVE?

— Ndërkohë që qëllimi i kontrabandimit të njerëzve është transportimi i paligjshëm ndërkufitar i njerëzve për të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, një përfitim financiar, ose përfitim tjetër material, qëllimi i trafikimit të qenieve njerëzore fillon me shfrytëzimin. Për më tepër, trafikimi i qenieve njerëzore nuk përfshin domosdoshmërisht kalimin e një kufiri; ai mund të zhvillohet dhe brendapërbrenda një shteti.



KUSH ËSHTË VIKTIMË E TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE?

— Çdokush mund të bëhet viktimë trafikimi – gra, burra dhe fëmijë; njerëz të të gjitha moshave dhe statuseve sociale. Njerëzit që bien viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore, për shembull, detyrohen të ofrojnë shërbime seksuale, punë me pak ose aspak pagesë, ose i nënshtrohen heqjes së organeve. Shfrytëzimi shpesh shoqërohet nga dhunë fizike dhe emocionale dhe me kërcënime të viktimave dhe të të afërmeve të tyre.

— Sipas Konventës një viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore është një person i cili është transportuar, rekrutuar, transferuar, strehuar ose marrë brenda një shteti ose përtej kufijve të një shteti, me anë të përdorimit të kërcënimit, mashtrimit, detyrimit, ose nëpërmjet formave të tjera të paligjshme, për qëllim shfrytëzimi.

— Një fëmijë konsiderohet si viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore pavarësisht nëse është përdorur ndonjë **mjet** për të rekrutuar, transportuar, transferuar, strehuar ose për ta marrë atë për qëllim shfrytëzimi.

— “Pëlqimi” i personit për t’u shfrytëzuar nuk ka rëndësi në rast se është përdorur ndonjëri nga **mjetet** (detyrimi, mashtrimi, abuzimi me pozicionin e vulnerabilitetit, etj.) e përmendura më lart. Për më tepër, një person do të konsiderohet si viktimë dhe në rast se shfrytëzimi nuk ka ndodhur ende, kur ai/ ajo kanë qenë objekt i njërit nga **veprimet** me përdorimin e njërit nga **mjetet**.

ÇFARË TË DREJTASH KANË VIKTIMAT E TRAFIKIMIT SIPAS KONVENTËS?

Identifikimi

— Viktimat e trafikimit duhet të identifikohen në mënyrë formale si të tilla, në mënyrë që të parandalohet trajtimi i tyre si emigrantë të parregullt ose si kriminelë. Identifikimi bëhet nga profesionistë të trajnuar posaçërisht (oficerë policie, punonjës socialë, inspektorë të punës, mjekë, ofrues të shërbimeve mbështetëse, etj.) të cilët ndjekin procedurat e rëna dakord si dhe kriteret përkatëse të identifikimit.

Periudha e rimëkëmbjes dhe e reflektimit

— Edhe përpara se viktimat të identifikohen formalisht si të tilla, ato kanë të drejtë të rimëkëmben për 30 ditë, të marrin veten, të largohen nga ndikimi i trafikantëve dhe të shqyrtojnë mundësinë e bashkëpunimit me organet përgjegjëse për hetimin e veprave të korrupsionit. Gjatë kësaj periudhe, ato nuk mund të dëbohen nga shteti dhe kanë të drejtë të marrin ndihmë dhe në rast se qëndrimi i tyre është i parregullt.

Ndihma

— Pavarësisht nëse viktimat janë të përgatitura të bashkëpunojnë në hetime, ose të bëhen dëshmitarë, ata kanë të drejtë të marrin:

- ▶ strehim të përshtatshëm dhe të sigurt
- ▶ ndihmë psikologjike
- ▶ ndihmë materiale
- ▶ akses në trajtim mjekësor urgjent
- ▶ shërbimet e përkthimit me shkrim dhe me gojë
- ▶ këshillim dhe informim
- ▶ ndihmë gjatë proceseve penale
- ▶ akses në tregun e punës, formimin dhe arsimin profesional, në rast se është rezident i ligjshëm në një vend.

Ndihma ligjore

— Viktimat e trafikimit kanë të drejtë të marrin informacion lidhur me të drejtat e tyre dhe me të gjitha procedurat përkatëse, në një gjuhë që ata e kuptojnë. Ata kanë po ashtu të drejtën e ndihmës ligjore dhe ndihmës juridike falas sipas kushteve specifike.

Leja e qëndrimit

— Viktimat mund të marrin rinovim të lejes së qëndrimit, nëse kërkohet prej situatës së tyre specifike, ose në rast se atyre u duhet të qëndrojnë në vend në mënyrë që të bashkëpunojnë me organet në hetimin e veprave të trafikimit. Dhënia e një leje qëndrimi nuk ndërhyt me të drejtën e tyre për të kërkuar azil.

Mbrojtja e jetës private dhe e identitetit

— Të dhënat personale të viktimës nuk mund të bëhen publike dhe mund të ruhen vetëm për qëllime specifike të ligjshme. Ato nuk mund të përdoren në asnjë mënyrë tjetër që lejon identifikimin e tyre.

Mbrojtja gjatë hetimeve dhe proceseve gjyqësore

— Viktimat dhe anëtarët e familjeve të tyre, kur është e nevojshme, marrin mbrojtje nga reprezaljet ose kërcënimet e mundshme nga trafikantët. Kjo mund të përfshijë mbrojtje fizike, vendosje në një vend tjetër, ndryshim të identitetit dhe ndihmë për gjetje pune.

Dëmshpërblimi

— Viktimat e trafikimit gëzojnë të drejtën e dëmshpërblimit financiar për dëmet e shkaktuara nga trafikantët. Dëmshpërblimi mund të jepet ose nga gjykata, pas konfiskimit të pasurive të trafikantëve, ose mund të jepet nga shteti ku ka ndodhur shfrytëzimi.

Riatdhesimi dhe kthimi

— Kthimi i viktimave në vendin e tyre të origjinës duhet të kryhet duke pasur parasysh të drejtat e tyre, sigurinë dhe dinjitetin, dhe duke marrë parasysh statusin e proceseve përkatëse ligjore. Pas kthimit, atyre u duhet ofruar ndihmë riintegrimi, si për shembull arsim dhe ndihmë për të gjetur punësim.

CILAT JANË TË DREJTAT E POSAÇME TË FËMIJËVE VIKTIMA TË TRAFIKIMIT?

— Përveç të drejtave të sipërpërmendura, të cilat zbatohen për të gjitha viktimat e trafikimit, fëmijët përfitojnë nga të drejtat e mëposhtme specifike:

- ▶ fëmijëve të pashoqëruar u caktohet një kujdestar ligjor për t'i përfaqësuar ata dhe për të vepruar në interesin e tyre më të mirë;
- ▶ merren masa për të përcaktuar identitetin dhe nënshtetësinë e fëmijëve dhe, në rast se është në interesin më të mirë për fëmijët, për të gjetur/lokalizuar familjet e tyre;
- ▶ kur moshja e viktimës nuk është e sigurt, por kur ka shkaqe të arsyeshme për të besuar se viktima është nën 18 vjeç, viktima supozohet të jetë fëmijë dhe përfiton masa të posaçme mbrojtjeje në pritje të verifikimit të moshës;
- ▶ fëmijët kanë të drejtë të përfitojnë masa arsimit dhe ndihme të cilat marrin parasysh nevojat e tyre;
- ▶ përpara riatdhesimit, që duhet të bëhet vetëm në rast se ai është në interesin më të mirë të fëmijës, kryhet një vlerësim rreziku dhe sigurie;
- ▶ fëmijët përfitojnë nga masa të posaçme mbrojtjeje gjatë hetimit dhe proceseve gjyqësore.





MONITORIMI DHE ZBATIMI I KONVENTËS

— Të gjitha shtetet që kanë nënshkruar Konventën e Këshillit të Evropës monitorohen rregullisht nga Grupi i Ekspertëve për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (GRETA). Roli i GRETA-s është të sigurojë zbatimin efektiv të dispozitave të Konventës dhe respektimin e të drejtave të viktimës.

— GRETA e analizon situatën për çdo shtet, duke hartuar raporte të cilat identifikojnë praktikatat e mira, mangësitë dhe bëjnë rekomandime për mënyrën e përmirësimit të zbatimit të Konventës nga çdo shtet. Raporte dhe rekomandimet janë bërë publike dhe janë botuar në faqen e internetit të antitrafikimit të Këshillit të Evropës.

Për kontakte dhe informacion të mëtejshëm

Sekretariati i Konventës së Këshillit të Evropës kundër Trafikimit
të Qenieve Njerëzore (GRETA dhe Komiteti i Palëve)

Këshillit të Evropës / Council of Europe

F-67075 Strasbourg Cedex

Francë / France

E-mail: Trafficking@coe.int

www.coe.int/trafficking